



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3684 Prot.

Tiranë, më 26.11.2021

**Lënda:** 4 Njoftim për caktim përfaqësuesish për të qenë të pranishëm në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, që do të funksionojë përgjatë vitit 2022.

**Drejtuar:** ZOTIT GENCI GJONÇAJ  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Tiranë

*I nderuar zoti Gjonçaj,*

Siç dhe mund të jeni në dijeni, Presidenti i Republikës në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës, nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemin të drejtësisë", të ndryshuar, ka vendosur të hedhë shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë viti 2022, ditën e premte, **datë 3 dhjetor 2021, ora 11:00**, në sallën "Skënderbej", në Institucionin e Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1 Tiranë.

Sa më sipër, Presidenti i Republikës, ka vlerësuar të ftojë përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, për të qenë të pranishëm në procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së (2022).

Duke vlerësuar formatin e parashikuar nga neni 233 i ligjit nr. 115/2016, mbi funksionarët që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përcillet kjo ftesë për Kuvendin e Shqipërisë i cili mund të jetë i pranishëm në momentin e hedhjes së shortit **maksimalisht me tre përfaqësues** (një përfaqësues i Kryetarit të Kuvendit dhe dy anëtarë prej komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore, njëri prej të cilëve përfaqësues i opozitës).

Lutemi dërgimin e emrit/emrave të përfaqësuesit/ve të institucionit tuaj.

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,*

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

